

Jeni viktimë e dhunës në familje, nëse ...

- partneri ndaj jush është i dhunshëm fizikisht (shuplaka, goditje, shkelmime, mbyllje nga banesa, tërheqje flokësh, ngulfatëje e ngjashëm),
- në ambientin shtëpiak përjetoni ofendime, qortime, nënçmime, kërcënime, kritika, përqeshje,
- partneri juaj ju ndjek si dhe ju kufizon tek lëvizja e lirë (dëshiron, që pareshtur ta dijë, se ku jeni, çka po bëni, me kë po shoqëroheni),
- partneri ju kontrollon telefonin, mesazhet, komunikimin përmes rrjeteve shoqërore, ju pamundëson kontaktimet telefonike/kontaktimet sociale me të tjerët,
- partneri ju merr paratë tuaja si dhe nuk keni mundësi që ato ti dispononi lirshëm,
- partneri i juaj është i dhunshëm (edhe) ndaj fëmijëve tuaj,
- ju kërcënon partneri, se do të ju pamundëson kontaktet me fëmijët, në rast se do të guxoni që ta braktisni,
- keni frikë nga partneri,
- ju shkakton partneri qëllimshëm ndjenje fajësie dhe turpi, kurse me këtë rast e ndjeni vetën të poshtëruar dhe turpëruar, të pa aftë,
- ju detyron partneri në marrëdhënie seksuale, praktika seksuale, me të cilat nuk jeni dakord ose i përjetoni si poshtëruese ose të dhimbshme,
- ju kërcënon partneri me vdekje,
- keni ndjesinë, se për veti dhe trupin tuaj nuk keni mundësi që vetë të vendosni si dhe ju duhet që të respektoni partnerin, i cili juve për mosdëgjim edhe ju sanksionon ...



NUK JENI VETËM. DO TË JU NDIHMOMJË.



Publikuar nga: Ministria e Punëve të Brendshme, Policia

Përgatitja: Administrata e Përgjithshme e Policisë,
Administrata e Policisë Kriminale

Dizajn: Shërbimi për Operacione Administrative

Shtyp: Tisk Žnidarič, d. o. o.

Tirazhi: 1000 kopje
Ljubljana 2023



DHUNA NË FAMILJE – INFORMATA KYÇE PËR VIKTIMA



Dhuna në familje

Nuk e ndjeni veten të sigurt në shtëpi, sepse partneri ndaj jush ushtron dhunë? E ndjeni veten, se partneri juaj pa ndërprerje mbikëqyrë jetën tuaj si dhe ju poshtëron? E ndjeni vetën, se dhuna juve në shtëpinë tuaj po ju ngërthen si dhe që lidhur me këtë nuk mundeni ti tregoni askujt? Keni frikë nga partneri?

Dhuna në familje nuk është një ndodhi e njëhershme, veçse bëhet fjalë për dhunë fizike, psikike, seksuale, ekonomike ndaj viktimës për kohë të gjatë ose që ta ndjekësh. Kryerësi e mbizotëron viktimën për shkak të tej forcës së tij, kurse viktimë lidhur me këtë është në pozitë të nënshtruar. Në rastet më të shumta viktimë nuk përjeton vetëmse njërin nga format e dhunës.

Dhuna në familje është e ndaluar si dhe është vepër penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Kjo do të thotë, se pas pranimi të paraqitjes policët do të bëjmë gjithçka, që mundemi, që viktimat ti mbrojmë në mënyrë adekuate, kurse kundër kryerësve do ti ndërmarrim masat në ujdi me autorizimet.

Viktimat e dhunës në familje shpeshherë e ndejnë vetën të turpëruar, fajtorë ose frikësuar, se askush nuk do të ju besoi. Vendimmarrja për kërkim të ndihmës si dhe largimi nga partneri i dhunshëm nuk është e thjeshtë, nganjëherë ka mundësi që tek partneri i dhunshëm kjo akoma ti stimuloi shpërthimet e tija të dhunës, e që në mënyrë shtesë ta rrezikoi sigurinë e viktimës si dhe anëtarëve tjerë të familjes.

Asnjë viktimë kundruall dhunës në familje nuk do të guxonte që të ballafaqohej vet. Ndihma e policisë është e domosdoshme për garantimin e sigurisë.

Çka ndodhë me rastin e paraqitjes së dhunës?

Dhunën në familje mund ta paraqitni në stacionin policor më të afërm, përmes internetit, për mes e-postës, kurse në rastin e ndodhive intervenuese përmes numrit të telefonit 113. Paraqitjen mund ta ushtroni edhe në mënyrë anonime në numrin e telefonit 080 1200. Paraqitjen e dhunës në familje mund ta bëj gjithkush, dëshmitari,

familjari, miku, kurse sipas detyrës zyrtare është e duhur që këtë ta bëjnë personat, të cilët tek zbatimi i punës kanë perceptuar, se ndaj personit po ushtrohet dhuna dhe se ka nevojë për ndihmë.

Përkundër frikës eventuale si dhe shqetësimit me rastin e ardhjes së policisë në shtëpi ose në stacionin policor tregoni sa më shumë të dhëna lidhur me dhunën, të cilën e përjetoni si dhe a keni nevojë për ndihmë shëndetësore.

Mos i ndërroni rrobat, mos e rregulloni banesën e shkapërderdhur si dhe gjësendet e shkatërruare.

Nëse keni vendosur, që paraqitjen e dhunës do ta ushtroni në stacionin policor kompetentë, me këtë rast ka mundësi që të ju shoqëroi personi i besueshëm, i cili mund të jetë shoku i juaj, një i njohur, bashkë familjarë ose përfaqësues i organizatës jo qeveritare. Policët tregoni, se kur ka filluar dhuna, çfarë mënyre të dhunës zbaton partneri juaj, nëse janë në rrezik edhe fëmijët e juve, cilat kanë qenë veprimet më të rrezikshme të dhunës, kur ka ndodhur ngjarja e parë/e fundit e dhunës si dhe kush tjetër dinë për dhunën si dhe do të kishte mundësi që të jep informata të rëndësishme.

Në rastin e kanosjes së rrezikut ndaj jush policët kanë mundësinë që kryerësit ti shqiptojnë ndalimin e afritit deri në 48 orë. Ndalimi i afritit do të thotë, se në këtë kohë partneri juve (dhe fëmijëve tuaj) nuk guxon që të ju afrohet në distancën, më të vogël se 200 metra. Ndalimi i afritit vlen edhe për komunikimin përmes mjeteve elektronike dhe rrjeteve shoqërore. Kryerësi policëve do të iu dorëzojë çelësat e vendbanimit të tyre të përbashkët, nga i cili do ti duhet që sa më parë të shpërngulet.

Nëse dëshironi që vetë të largoheni nga kryerësi, policët me rastin e paraqitjes do të ju ndihmojnë në siguri, me largimin në shtëpinë e sigurt ose qendrën e krizave. Në rastin e këtyllë policët në lutjen tuaj do të ju shoqërojnë deri në adresën tuaj shtëpiake, ku do të keni mundësi që sigurt ti merrni gjërat tuaja më të rëndësishme si dhe gjërat e fëmijëve tuaj.

Për mbrojtjen tuaj në rastin e paraqitjes së dhunës në familje policia do ta informoi edhe qendrën kompetente për punë sociale, ku do të ju japin përkrahjen shtesë tek largimi nga partneri i dhunshëm, do të ju njoftojnë me të drejtat dhe mundësitë si dhe do të ju ndihmojnë që ta formoni rrjetin mbështetës.

Për policët siguria dhe mbrojtja e viktimës janë detyrat më të rëndësishme përgjatë ndërmjetësimit në rastet e dhunës në familje. Policia me rastin e njohjes së dyshimit të veprës penale do të filloi të tuboi informatat, edhe pse vet ju akoma nuk jeni të gatshëm që të ushtroni paraqitjen kundër shkaktesës. Është botërisht e ditur, se në momentin, kur viktimë fillon që të rezistoi ndaj dhunës, dëshiron që të largohet ose kërkon ndihmë, dhuna e partnerit shpeshherë rritet. Shih për këtë ju këshillojmë, që të vendosni për bisedë këshilluese në qendrën kompetente për punë sociale ose në ndonjërin midis organizatave jo qeveritare, të cilat merren me viktimat e kësaj vepre penale.

Në kohën, kur vendosni për paraqitjen e kësaj vepre penale, kujdesuni për sigurinë tuaj si dhe sigurinë e fëmijëve tuaj. Telefoni mbajeni me veti, nëse do ndodhë ngjarja e dhunshme si dhe do të keni nevojë për ndihmë e policisë. Numrin telefonik të policisë duhet ta keni të kurditur për thirrje emergjente. Pranë kësaj të gjithë numrat emergjentë të telefonit duhet ti shënoni në disa lista si dhe i ruani në gjepa në disa rroba. Keni kujdes për atë, që pranë vetes ti keni dokumentet personale, sipas mundësisë edhe fotokopjoni. Mirëpo para së gjithash kur merrni vendimin për paraqitje e dhunës të jeni i vetëdijshëm, se ju duhet që së pari të kujdeseni për sigurinë tuaj, për dhunën, viktimë e të cilës jeni, kurrë mos e fajësoni vetveten. Për dhunë gjithmonë përgjegjës është ekskluzivisht dhe vetëmse shkaktesa. Sjelljet e tija vetë nuk mundeni ti ndryshoni. Për ndryshim duhet që vetë ta kuptoi, se ka probleme, si dhe të kërkojë ndihmë profesionale. Kërkoni ndihmë për veti tek anëtarët tjerë të familjes, tek miqtë tuaj, të njohurit dhe bashkëpunëtorët. Tregojni të gjithëve, se ç'po ju ndodhë si dhe iu lutni, që të ju ndihmojnë me rastin e parashtimit të paraqitjes si dhe mundësisë eventuale të strehimit në vend të sigurte.

Policët jemi të punësuar për atë, që të ju ndihmojmë lidhur me garantimin e sigurisë. Do të reflektojmë në secilën thirrje tuaj si dhe me këtë rast edhe do të ndërmarrim masat adekuate kundër shkaktesës, kurse juve do të ju mbrojmë.